



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 209 / 22

Nr. i fq. / Br. sh. - 28 -

Data: / Datum 06. 09. 2022

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E VUSHTRRIË
OPŠTINA VUČITRN
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

STATUTI I KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Shtator, 2022

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (a) dhe paragrafi 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **6 shtator 2022**, miraton këtë:

STATUT

01.Nr-209/2022

TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Përkufizimi

1. Statuti i komunës (në tekstin e mëtejme Statuti) është akti më i lartë juridik i komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Statuti është akti më i lartë juridik i komunës, i cili siguron zbatimin e kompetencave dhe përgjegjësiive të komunës në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera dhe aktet nënligjore.
3. Statuti rregullon kompetencat dhe organizimin e komunës, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes për punët publike, organet e komunës, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.

Neni 2

Statusi juridik

Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera dhe Statutin e komunës.

Neni 3

Selia e komunës

Selia e komunës gjendet në Vushtrri, sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10.

Neni 4

Festat e komunës

1. "Dita e Çlirimit të Vushtrrisë" është 17 qershor 1999. Kjo ditë shënohet çdo vit.
2. Dita e Dëshmorëve të Kombit, të Komunës së Vushtrrisë është 1 shtatori. Kjo ditë shënohet çdo vit.
3. Komuna e Vushtrrisë feston edhe festat tjera të parapara me Ligjin për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 5 **Simbolet komunale**

1. Komuna ka emblemën dhe flamurin e vet. Ato përdoren brenda territorit të saj në pajtim me Ligjin për Simbolet Shtetërore. Simbolet nuk duhet t'ju përngjajnë simboleve të shteteve tjera apo simboleve të komunave në Republikën e Kosovës ose jashtë saj.
2. Përmbajtja, përdorimi dhe ndryshimi i emblemës dhe flamurit, do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës, në pajtim me Ligjin për Simbole Shtetërore.
3. Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç komunës, nuk mund ta përdorë emblemën, flamurin dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga Kuvendi i komunës.
4. Simbolet e komunës miratohen apo ndryshohen me së paku 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

Neni 6 **Vulat**

1. Komuna e Vushtrrisë dhe organet e saj e kanë vulën e rrumbullakët dhe atë katrore.
2. Përmasat, përmbajtja e tekstit, mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave, është e përcaktuar me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës, në pajtim me Ligjin për Vula.
3. Përmbajtja e tekstit të vulave është e shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Neni 7 **Statusi ligjor i komunës**

1. Komuna e ka statusin e personit juridik, si dhe e ka të drejtën:
 - 1.1. të paditë dhe të paditet në gjykatë;
 - 1.2. të posedojë, të menaxhojë pasurinë dhe të përcaktojë kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të saj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj;
 - 1.3. mund të jetë pronare dhe bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
 - 1.4. të lidhë kontrata;
 - 1.5. të punësojë stafin, dhe
 - 1.6. të angazhohet në aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj.

Neni 8 **Komuna**

Organet e Komunës së Vushtrrisë, kujdesen që të gjithë qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindjeje apo ndonjë statusi tjetër, me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet.

Neni 9
Marrëdhëniet kontraktuale

1. Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saj në fusha të caktuara te komunat tjera, apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit, në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.
2. Vendimin për delegimin e përgjegjësisë në fusha të caktuara dhe për bashkëpunim e miraton Kuvendi i komunës.

KAPITULLI II
Lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet

Neni 10
Lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet

1. Territori dhe kufijtë e komunës janë të përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.
2. Territori i Komunës së Vushtrrisë si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanime sipas zonave kadastrale, si në vijim:

2.1. Qyteti: Vushtrri;

2.2. Lagjet urbane: “Lagjja Qendra”, “Lagjja Kalaja”, “Lagjja Ura e Vjetër e Gurit”, “Lagjja Vicianë”, “Lagjja Dardania”, “Lagjja Silnica” dhe “Lagjja Iliria”.

2.3. Fshatrat:

- | | |
|------------------------|----------------|
| 1. Akrashticë, | 20. Gllavatin, |
| 2. Balincë, | 21. Gojbulë, |
| 3. Bajskë, | 22. Gracë, |
| 4. Beçiq, | 23. Gumnishtë, |
| 5. Beçuk, | 24. Hercegovë, |
| 6. Begaj, | 25. Karaçë, |
| 7. Bivolak, | 26. Kollë, |
| 8. Boshlan, | 27. Kunovik, |
| 9. Brusnik, | 28. Kurillovë, |
| 10. Bukosh, | 29. Liqej, |
| 11. Ceceli, | 30. Lumadh, |
| 12. Dalak, | 31. Mavraj, |
| 13. Dobërlukë, | 32. Maxhunaj, |
| 14. Druar, | 33. Mihaliq, |
| 15. Duboc, | 34. Miraçë, |
| 16. Dumnicë e Epërme, | 35. Nedakoc, |
| 17. Dumnicë e Llugës, | 36. Novolan, |
| 18. Dumnicë e Poshtme, | 37. Oshlan, |
| 19. Galicë, | 38. Pantinë, |

39.	Pasomë,	53.	Stanoc i Poshtëm,
40.	Pestovë,	54.	Stroc,
41.	Prelluzhë,	55.	Studime e Epërme,
42.	Reznik,	56.	Studime e Poshtme
43.	Ropicë,	57.	Shalë,
44.	Samadrexhë,	58.	Shlivovicë,
45.	Sfaraçak i Epërm,	59.	Shtitaricë,
46.	Sfaraçak i Poshtëm,	60.	Taraxhë,
47.	Skoçan,	61.	Tërllobuq,
48.	Skromë,	62.	Vesekoc,
49.	Sllakoc,	63.	Vërnice,
50.	Sllatinë,	64.	Vilanc,
51.	Smrekonicë,	65.	Zagorë,
52.	Stanoc i Epërm,	66.	Zhilivodë.

3. Me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës, mund të përcaktohen lagje, vendbanime periferike dhe vendbanime tjera komunale.
4. Me rregullore të miratuar nga ana e Kuvendit të komunës, do të rregullohet struktura organizative dhe funksionale e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe mënyra, koha, numri dhe çështje tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

Neni 11 **Kufijtë e komunës**

Ndryshimi i kufijve të komunës mund të bëhet në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave dhe në bazë të aprovimit paraprak nga Kuvendi i komunës.

Neni 12 **Raportet me lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet**

Komuna, me vendim të Kuvendit për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës komunale.

KAPITULLI III Kompetencat dhe përgjegjësitë e komunës

Neni 13 Kompetencat vetanake

1. Komuna i ka kompetencat e plota dhe ekskluzive në fushat që vijojnë:
 - 1.1. zhvillimin lokal ekonomik;
 - 1.2. planifikimin urban dhe rural;
 - 1.3. mbrojtjen e mjedisit lokal;
 - 1.4. shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
 - 1.5. zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
 - 1.6. ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale;
 - 1.7. përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
 - 1.8. ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e pagave, trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
 - 1.9. promovimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin e barazisë gjinore;
 - 1.10. ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
 - 1.11. ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e qendrave të përkujdesit, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
 - 1.12. banimin publik;
 - 1.13. shëndetësinë;
 - 1.14. licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe aktivitetet e lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë;
 - 1.15. emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
 - 1.16. ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike;
 - 1.17. turizmin;
 - 1.18. aktivitetet kulturore, rinore, sportive dhe të lira;
 - 1.19. çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër;
 - 1.20. të gjitha çështjet tjera, të cilat me ligj ose akte nënligjore janë paraparë si kompetenca vetanake të komunës.

2. Komuna e Vushtrrisë, si plotësim i aktiviteteve të përmendura më sipër, ushtron kompetencat e deleguara.

Neni 14

Kompetencat e deleguara

1. Institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin, i delegojnë komunës kompetencat vijuese:
 - 1.1. shënimet kadastrale;
 - 1.2. regjistrimin civil;
 - 1.3. regjistrimin e votuesve;
 - 1.4. regjistrimin e biznesit dhe licencimin, distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
 - 1.5. mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria.

2. Komuna e Vushtrrisë ushtron përgjegjësitë tjera shtesë, përveç atyre të cekura në pikën 1 të këtij neni, gjithnjë duke u përkujdesur që kompetencat e deleguara shtesë të shoqërohen me financim të nevojshëm për të përmbushur objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

KAPITULLI IV

Neni 15

Organet e komunës

Organet e komunës janë:

1. Kuvendi i komunës, dhe
2. Kryetari/ja i/e komunës.

Neni 16

Kuvendi i komunës

1. Kuvendi i komunës është organi më i lartë në komunë, i cili ushtron funksionin përfaqësues dhe vendimmarrës në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.
2. Kuvendin e komunës e përbëjnë anëtarët e zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët me votim të fshehtë, në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.
3. Kuvendi i Komunës të Vushtrrisë i ka 35 anëtarë.
4. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është katër (4) vjet.
5. Anëtarit të Kuvendit të komunës i pushon mandati i anëtarit, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 17
Funksionet e Kuvendit të komunës

1. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të komunës dhe akteve tjera nënligjore.
2. Kuvendi i komunës e miraton dhe ndryshon Statutin e komunës, konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
3. Miratimi apo ndryshimi i Statutit të komunës duhet të aprovohet më së paku me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
4. Kuvendi i komunës e miraton Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshojë atë. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores të punës aprovohet me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit të komunës.
5. Kuvendi i komunës ndan dekorata për individë dhe persona juridikë, për kontributet dhe vlerat, rolin e tyre në jetën publike. Me rregullore të veçantë përcaktohen kushtet dhe mënyra e ndarjes së dekoratave, titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve.
6. Kuvendi i Komunës merr vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarëve, shtatoreve dhe pllakave përkujtimore.
7. Kuvendi i komunës vendos lidhur me propozimet për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore.
8. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit me nënshkrimet e prezentuara mund të fillojnë iniciativën për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore.
9. Propozues mund të jetë Kryetari i komunës, dhe
10. 10% e qytetarëve me të drejtë vote në Komunën e Vushtrrisë.
11. Vendimi për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore, merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit të komunës. Votimi në të gjitha rastet bëhet në mënyrë të fshehtë.

Neni 18 **Përgjegjësitë**

1. Kuvendi i komunës nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e veta për marrjen e vendimeve lidhur me:
 - 1.1. Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret dhe aktet tjera komunale; miratimin; ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
 - 1.2. Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
 - 1.3. Miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo Rregulloreve të punës;
 - 1.4. Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
 - 1.5. Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas LVL-së dhe këtij Statuti;
 - 1.6. Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit komunës;
 - 1.7. Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
 - 1.8. Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - 1.9. Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
 - 1.10. Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
 - 1.11. Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
 - 1.12. Përgjegjësitë tjera që kërkohen me ligj për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit përkatës të Kuvendit të komunës, apo Kryetarit/es të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin e pushtetit në çdo kohë;
 - 1.13. Caktimin e lokacioneve me interes të përgjithshëm;
 - 1.14. Themelimin e komisioneve sipas nevojës (puna në komisione duhet të kompensohet konform vendimit të Kuvendit).

Neni 19 **Aktet e Kuvendit të komunës**

1. Kuvendi i komunës, në kuadër të kompetencave të tij miraton këto akte:
 - 1.1. Statutin e komunës;
 - 1.2. Rregulloren e punës;
 - 1.3. Rregulloret komunale;
 - 1.4. Vendimet;
 - 1.5. Çdo akt tjetër të nevojshëm për funksionim efikas të komunës.
2. Aktet e Kuvendit të komunës vlejné vetëm brenda territorit të komunës.
3. Rregullorja mbi punën e Kuvendit miratohet dhe ndryshohet me votimin e shumicës të anëtarëve të Kuvendit të komunës.
4. Aktet tjera dhe vendimet e Kuvendit të komunës aprovohen nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me ligj.

Neni 20
Mbledhja inauguruuese, betimi dhe deklarata solemne

1. Kuvendi i komunës duhet të mbajë mbledhjen e parë inauguruuese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Mbledhja inauguruuese e Kuvendit të komunës thirret nga Kryetari/ja i/e komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
3. Nëse nuk thirret mbledhja sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruuese thirret nga anëtari/ja më i/e vjetër, i/e zgjedhur i/e Kuvendit të komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data kur Kryetari/ja është dashur të thërrasë mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të komunës.
4. Nëse anëtari/ja më i/e vjetër i/e Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij/saj në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruuese e Kuvendit të komunës caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të komunës.
5. Mbledhjet e Kuvendit të komunës të cilat mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, kryesohen nga anëtari/ja më i/e moshuar i/e Kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 21
Mandati

Mandati i çdo anëtari/reje të Kuvendit të komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i komunës, para nënshkrimit të deklaratës solemne nga secili anëtar i Kuvendit të komunës.

Neni 22
Betimi i anëtarëve të Kuvendit

1. Anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:
"Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime, e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, si dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar/re i/e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".
2. Anëtarët e Kuvendit të komunës të cilët/at nuk e nënshkruajnë betimin solemn ose mandatin në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, brenda një (1) muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë.

Neni 23
Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës

1. Kuvendi i komunës e zgjedh Kryesuesin/en e Kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve, me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të komunës. Propozimlista për Kryesues/e të Kuvendit të komunës duhet të ketë një e më shumë kandidatë/e të mundshëm/e për t'u zgjedhur Kryesues/e i/e Kuvendit të komunës.
2. Votimi për Kryesues/se të Kuvendit të komunës bëhet me vota të fshehta. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati i propozuar si Kryesues/e i/e Kuvendit, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
3. Në rast se, në votimin e parë asnjëri/ra prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur, do të zgjedhet Kryesues/se i/e Kuvendit të komunës.
4. Nëse edhe pas votimit të dytë, asnjëri/ra nga kandidatët/et nuk e ka fituar shumicën e kërkuar të votave si në paragrafin 3 të këtij neni, shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryesues/ja i/e Kuvendit të komunës, zgjedhet kandidati/ja, i/e cili/a merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës, atëherë i tërë procesi i votimit përsëritet me propozimin e kandidatëve tjerë për Kryesues/e të Kuvendit. Kur procesi i zgjedhjes bëhet me votim të fshehur, nuk ka vota të abstenuara, kurse votat e pavlefshme llogariten pjesëmarrje në votim.

Neni 24
Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit

1. Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të komunës, formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesuesin/en e Kuvendit, i cili/a përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë të Kuvendit të komunës.
2. Komisioni për votim është përgjegjës që të numërojë votat dhe t'i komunikojë rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të komunës.

Neni 25
Nënshkrimi i akteve të Kuvendit

Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i nënshkruan të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i komunës dhe është i/e obliguar të kujdeset për procedimin e tyre, ndërkaq një kopje të aktit të nënshkruar ia dorëzon Kryetarit/es të komunës dhe organeve përgjegjëse për zbatim.

Neni 26
Shkarkimi i Kryesuesit/es të Kuvendit

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit mund të shkarkohet me votat e më tepër se 50% plus një votë, të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

2.Kërkesën për shkarkim të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës mund ta bëjë me shkrim dhe nënshkrimet e së paku një të tretat (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes të mbledhjes së rregullt.

3.Lidhur me shqyrtimin e kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, vendos Kuvendi i komunës me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.

4.Votimi për shkarkimin e Kryesuesit/es bëhet me votim të fshehtë.

5.Të gjitha procedurat tjera për shkarkim rregullohen me Rregulloren e punës të Kuvendit.

Neni 27 **Kuorumi dhe votimi**

1. Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit apo komiteteve. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi që merr Kuvendi i komunës.
2. Në të gjitha takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, çdo anëtar, duke përfshirë edhe Kryesuesin e mbledhjes, ka nga një votë, por Kryesuesi e ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë »për« apo »kundër« një propozimi.
3. Kuvendi i komunës dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregullore të punës të Kuvendit të komunës.
4. Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë Statut dhe ligj, vendimet e Kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.
5. Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 28 **Mbledhjet e Kuvendit të komunës**

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhjen e kryeson anëtar/ja më i/e vjetër i/e Kuvendit të komunës.
2. Kuvendi i komunës mban së paku dhjetë (10) seanca në vit, pesë (5) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e punës.
3. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim ashtu siç kërkohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:
 - 3.1. data e mbajtjes së mbledhjes;
 - 3.2. koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - 3.3. vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - 3.4. rendi i ditës për mbledhje;

- 3.5. materialet e mbledhjes, dhe
- 3.6. të dhëna tjera që mund të përcaktohen me këtë Statut ose Rregullore të punës.
4. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin për Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.
5. Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.
6. Në mbledhjen e tyre të parë të çdo viti vijues, Kuvendi i komunës dhe secili komitet duhet t'i caktojë datat në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjatë vitit. Mbledhjet plotësuese mund të thirren në çdo kohë. Datat e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohen me vendime tjera.

Neni 29 **Udhëheqja e mbledhjeve**

Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës së Kuvendit. Kryesuesi/ja thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke siguruar që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje, të kenë të drejta të njëjta dhe të barabarta, si dhe të kenë mundësi të marrin pjesë të barabartë në diskutime dhe votim.

Neni 30 **Transparenca**

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të Kuvendit të komunës janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara për temat që janë objekt diskutimi, përveç në rastet kur parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.
2. Në qoftë se Kuvendi i komunës gjatë punës së tij vendos që për arsye të caktuara me ligj, të përjashtojë publikun në shqyrtimin e ndonjë çështjeje nga seanca e Kuvendit, duhet të marrë vendim me shumicë votash të anëtarëve prezent, për përjashtim të publikut.
3. Kuvendi i komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, njofton publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme.
4. Komitetet obligative nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, njoftojnë publikun 3 ditë pune para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve.

Neni 31 **Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës dhe procesverbali**

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës, caktohet me kërkesën e bërë me shkrim, nga më së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës apo me kërkesë të Kryetarit/es.
2. E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme, gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të

- ndryshohen gjatë mbledhjes.
4. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës nuk mbahet nëse nuk janë të njoftuar me shkrim të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës dhe publiku, siç kërkohet me Rregulloren e punës së Kuvendit, së paku tri (3) ditë pune para datës të mbajtjes së takimit.
 5. Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
 6. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.
 7. Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbali përmban emrat e anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, anëtarëve dhe personave tjerë të ftuar, rendin e ditës, esencën e diskutimeve, rezultatin numerik të votimit, si dhe evidentimin e çfarëdo vote që ka dhënë çdonjëri, nëse kërkohet nga anëtari i Kuvendit për propozimet e miratuara apo të refuzuara.
 8. Procesverbalin e mban një shërbyes/se civil/e komunal/e, i/e caktuar nga shërbimet e Kuvendit të komunës. Në konsultim me Kryesuesin/en e Kuvendit të komunës, çdokush ka të drejtë të shikojë procesverbalin dhe të marrë një kopje. Procesverbali mbahet në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe i njëjti duhet të miratohet në takimin e ardhshëm të Kuvendit. Procesverbalet duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi/ja i/e mbledhjeve dhe nga zyrtari/ja i/e autorizuar për mbajtjen e procesverbalit.

Neni 32

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të komunës

1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit. Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe në Rregulloren e tij të punës.
2. Anëtari i Kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.
3. Anëtari i Kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.
4. Anëtari i Kuvendit të komunës mund t'ju drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të komunës, anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë Kryesuesit/es të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.
5. Anëtari i Kuvendit të komunës mund të kërkojë informacione nga Kryetari, të cilat janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në Kuvendin e komunës.
6. Anëtari i Kuvendit të komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të Kuvendit.
7. Kuvendi i komunës, në pajtim me Statutin e komunës dhe me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, mund t'ju ofrojë kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvendin e komunës.
8. Anëtarët e Kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e thirrura

të Kuvendit, në mënyrë të duhur, në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Neni 33

Konflikti i interesit i anëtarëve të Kuvendit

1. Anëtari/ja i/e Kuvendit të komunës, apo anëtari/ja i/e komitetit dhe i komisionit, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij/saj, ka interes personal dhe material.
2. Anëtarët e Kuvendit të komunës, të komiteteve dhe të komisioneve duhet t'i shfaqin të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent.
3. Anëtarët e Kuvendit të komunës nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë në administratën e komunës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 34

Deklarata financiare

Në pajtim me LVL, çdo anëtar/e i/e Kuvendit të komunës para mbledhjes së parë të Kuvendit të komunës, duhet t'i regjistrojë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare, si dhe obligohet të shënojë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare, posa ato të ndodhin në regjistrin që e mban Kryetari/ja i/e komunës.

Neni 35

Pushimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit

1. Anëtari i Kuvendit të komunës, i/e cili/a nuk nënshkruan betimin – deklaratën solemne brenda një (1) muaji pas zgjedhjes, pa arsye, pushon të jetë anëtar i Kuvendit.
2. Nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur, kalon për të jetuar në territorin e një komune tjetër, sipas evidentimit të regjistrit të gjendjes civile.
3. Nëse anëtari paraqet dorëheqjen me shkrim nga posti i tij.
4. Nëse anëtari është i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë (6) ose më shumë muaj.
5. Nëse anëtari i Kuvendit të komunës nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të komunës pa arsye.
6. Nëse ai/ajo vdes.
7. Me përfundimin e mandatit.

KAPITULLI V

Neni 36 Komitetet e përhershme

1. Kuvendi i komunës themelon komitete të përhershme siç janë:
 - 1.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe
 - 1.2. Komiteti për Komunitete.

Neni 37 Komiteti për Politikë dhe Financa

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të zgjedhen nga radha e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e komunës.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, marrjen e raporteve nga Kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.
5. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
6. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
7. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi/ja e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhja kryesohet nga anëtari/ja më i/e vjetër i/e komitetit.

Neni 38 Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete mund t'i ketë nëntë (9) anëtarë.

1. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, zgjedhen nga Kuvendi i komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.
2. Komunitetet pakicë në komunë, duhet të kenë përfaqësimin e paraparë me ligjin në fuqi në Komitetin për Komunitete.
3. Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
4. Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë, përfaqësohet nga së paku një (1) përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.

5. Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 39

Komitetet konsultative

1. Komitetet konsultative janë trupa ndihmës të Kuvendit të komunës, roli i të cilëve është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet komunale të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.
2. Kuvendi i komunës përveç komiteteve si trupa punuese të tij, me vendim të veçantë mund të themelojë komitete konsultative në pajtim me ligjet në fuqi.
3. Themelimi i komiteteve konsultative në komunë ka për qëllim që qytetarët dhe grupet tjera të interesit, të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes për interes publik.
4. Kuvendi i komunës mund të themelojë edhe komitete konsultative ad hoc, për çështje të caktuara, kurse mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes.
5. Për themelimin e secilit komitet, duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të komunës.
6. Anëtarët e komiteteve konsultative, zgjedhen në bazë të konkursit publik për mandat katërvjeçar. Asnjë anëtar i komitetit këshillëdhënës nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.
7. Kuvendi i komunës me vendim të posaçëm, cakton numrin e anëtarëve të komiteteve konsultative, numri i të cilëve nuk mund të jetë më tepër se shtatë (7).
8. Për të gjitha çështjet tjera që lidhen me punën e komiteteve konsultative, do të zbatohen dispozitat e udhëzimeve administrative me të cilat rregullohet mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komiteteve konsultative në komunë.
9. Përbërja e komiteteve konsultative duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
10. Komitetet në kuadër të kompetencave të veta lidhur me çështjet e caktuara, mund t'i rekomandojnë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të komunës, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve përkatëse.
11. Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të çështjeve të caktuara nga kompetencat e tij, ia rekomandon Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe marrjen e vendimeve përkatëse.

Neni 40
Transparenca publike e punës e Kuvendit dhe komiteteve

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës, komiteteve dhe komisioneve tjera të tij, janë të hapura për publikun.
2. Kuvendi i komunës, komitetet dhe komisionet tjera mund të vendosin për përjashtimin e publikut nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e mediave.
3. Vendimet për përjashtimin e publikut dhe mediave, merren me shumicë të anëtarëve të Kuvendit të komunës, komiteteve ose komisioneve tjera.

KAPITULLI VI

Neni 41
Zgjedhja e Kryetarit/es të komunës

1. Kryetari/ja i/e komunës zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me Ligjin mbi Zgjedhjet Komunale në fuqi.
2. Kryetari/ja i/e komunës zgjedhet për mandat të njëjtë, sikurse anëtarët e Kuvendit të komunës në pajtim me ligjin.

Neni 42
Betimi i Kryetarit të komunës

I .Në rastin e zgjedhjes, Kryetari/ja i/e komunës e bën betimin apo deklaratën solemne përpara anëtarëve të Kuvendit të komunës.

Teksti i betimit në vijim:

"Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë".

2. Kryetari/ja që dështon të jepë betimin brenda një (1) muaji, nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, e humb mandatin.

Neni 43
Përgjegjësitë e Kryetarit/es

1. Kryetari/ja i/e komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:
 1. Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj.
 2. Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj, si dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës.
 3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të komunës apo komiteteve të tij.

4. Ekzekuton aktet e Kuvendit të komunës.
5. Emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj.
6. Emëron dhe shkarkon *këshilltarët e tij dhe stafin mbështetës*, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave.
7. Organizon punën dhe drejton politikën e komunës.
8. Propozon rregullore apo akte tjera për miratim në Kuvendin e komunës.
9. Propozon zhvillimin e komunës, planet rregulluese dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar.
10. Raporton para Kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i komunës.
11. Mund të kërkojë që Kuvendi i komunës të shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
12. Ndan mirënjohje dhe falënderime
13. Themelon komitetin për auditim, sipas legjislacionit në fuqi.
14. Themelon komisione dhe grupe punuese sipas fushave të caktuara në pajtim me ligjin;
15. Shpall ditë zie në komunë në rast të ndonjë fatkeqësie të rëndë për komunën.
16. Ushtron përgjegjësi tjera të përcaktuara më ligj.

Neni 44

Aktet e Kryetarit/es të komunës

1. Kryetari i komunës merr vendime dhe lëshon urdhëresa brenda fushës dhe kompetencave të tij.
2. Kryetari i komunës jep autorizime, nënshkruan marrëveshje në emër dhe llogari të komunës, si dhe akte tjera në pajtim me ligjin.

Neni 45

Përfundimi i mandatit të Kryetarit

1. Mandati i Kryetarit/es të komunës përfundon:
 - 1.1. Kur të kryejë mandatin e tij;
 - 1.2. Nëse vdes;
 - 1.3. Nëse jep dorëheqje;
 - 1.4. Nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
 - 1.5. Nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj, pa arsye;
 - 1.6. Nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me LVL;
 - 1.7. Në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon Kryetarin e komunës nga cilësia juridike, dhe
 - 1.8. Në rast të dënimit për veprë penale, me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 46
Delegimi i kompetencave në mungesë të Kryetarit

Nëse Kryetari/ja i/e komunës përkohësisht mungon apo përkohësisht nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e tij/saj, nënkryetari/ja i/e komunës me kërkesë të tij ose saj i ushtron funksionet ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit/es të komunës, ndërsa në mungesë edhe të nënkryetarit, Kryetari me autorizim e cakton njërin nga drejtorët e drejtorive t'i kryejë detyrat e tij/saj dhe ushtron funksionet ekzekutive të përditshme, si dhe vepron në emër të Kryetarit/es të komunës.

Neni 47
Suspendimi dhe shkarkimi nga detyra i Kryetarit/es të komunës

Kryetari/ja mund të suspendohet dhe shkarkohet sipas procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 48
Konflikti i interesave

1. Dispozitat e LVL, do të zbatohen në rast të konfliktit të interesit të Kryetarit/es të komunës. Menjëherë pas zgjedhjes së tyre, Kryetari/ja i/e komunës e ndërpreu çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë të tij, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Neni 49
Nënkryetari/ja i/e komunës

1. Në komunë, Kryetari/ja i/e komunës e ka një nënkryetar/e. Nënkryetari/ja emërohet nga Kryetari/ja për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari/ja.
2. Me kërkesë të Kryetarit/es, nënkryetari/ja i ndihmon Kryetarit/es në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit/es në mungesë të tij.
3. Kur posti i nënkryetarit/es mbetet i lirë, Kryetari/ja emëron nënkryetarin/en e ri/re, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas paraqitjes të postit të lirë.
4. Për konfliktin e interesit të nënkryetarit/es, përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që rregullon konfliktin e interesit për Kryetarin/en e komunës.

Neni 50
Kompensimet

1. Për punën që bëjnë për komunën: - Kryetari/ja i/e komunës, nënkryetari/ja e komunës, kryesuesi/ja dhe zëvendeskryesuesi/ja i/e KK-së, anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët e komiteteve përkatëse, kompensohen në harmoni me rregullat e përcaktuara nga autoriteti qendror i Kosovës.
2. Lartësia e kompensimit të anëtarëve të komiteteve tjera dhe komisioneve të formuara nga

Kuvendi i komunës, caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës dhe duhet të jetë ekuivalente me kompensimin që i bëhet komiteteve të përhershme të KK-së.

KAPITULLI VII

Neni 51

Administrata e komunës

1. Administrata e komunës organizohet në drejtori, ku secila drejtori komunale udhëhiqet nga drejtori/eshë. Drejtorët i emëron dhe shkarkon Kryetari i komunës.
2. Komuna e Vushtrisë organizohet në më së shumti 14 (katërmëdhjetë) drejtori.
3. Kryetari i komunës ka kompetencë ekskluzive në caktimin e numrit të drejtorive, konform paragrafit 2 të këtij neni.
4. Kryetari i komunës me akt të brendshëm përshkruan kompetecat dhe përgjegjësitë e secilës drejtori, duke përfshirë edhe emërtimet e drejtorive.
5. Kryetari i komunës në mbledhjen e parë të Kuvendit të komunës, pas themelimit të drejtorive prezenton numrin, emërtimin e drejtorive dhe emrat e drejtorëve.
6. Kryetari i komunës njofton Kuvendin e komunës në rast të ndryshimit të emërtimit të ri të ndonjë drejtori apo drejtorie.

Neni 52

Konfliktet e interesit për drejtorët

1. Çdo drejtor/eshë do të përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjeje, për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij apo të saj, ka ndonjë interes personal ose financiar.
2. Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash, në një regjistër të cilin e mban Drejtoria për Administratë dhe personeli.

Neni 53

Zyrat komunale

Përveç drejtorive të komunës, në kuadër të Administratës komunale, ekzistojnë edhe këto zyra dhe njësi:

1. Kabineti i Kryetarit/es.
2. Sektori për punë të Kuvendit të komunës – Sekretaria.
3. Zyra e Kryetarit të komunës.
4. Njësia për personel.
5. Njësia për të drejtat e njeriut.
6. Njësia e auditimit të brendshëm.
7. Zyra për menaxhimin e projekteve.
8. Zyra e informimit.
9. Zyra për komunitete dhe kthim.
10. Zyra ligjore.
11. Zyra për barazi gjinore.
12. Zyra për integritet dhe diasporë.

KAPITULLI VIII
Financat e komunës dhe procedurat buxhetore

Neni 54
Financat e komunës dhe procedurat buxhetore

1.Komuna e Vushtrrisë ka buxhetin dhe financat e saj. Buxheti i komunës përbëhet prej të hyrave vetanake, granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacionet dhe të hyrat tjera, të cilat rregullohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe aktet tjera.

2.Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të komunës janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 55
Të hyrat vetanake të komunës

Komuna mbledh të hyra vetanake në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Të hyrat planifikohen, përcaktohen, ndryshohen dhe aprovohen nga Kuvendi i komunës në harmoni me ligjin.

Neni 56
Dëgjimet publike buxhetore

1. Drejtoria përgjegjëse për financa është kompetente për koordinimin e përgjithshëm të procesit të buxhetit, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij, procesin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun, në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, në pajtim me ligjin dhe udhëzimet e ministrisë së linjës.
2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organizon dëgjime publike me qytetarë dhe palët e interesit, duke inkorporuar propozimet e arsyeshme të qytetarëve.
3. KPF-ja në bashkëpunim me Kryetarin e komunës, i rekomandon Kuvendit të komunës për miratim Draft-buxhetin vjetor.

Neni 57
Raporti vjetor

Kryetari/ja i/e komunës obligohet që të paraqitë raport të detajuar vjetor në Kuvendin e komunës në afatet ligjore.

Neni 58
Miratimi i buxhetit

Kryetari/ja i/e komunës ia propozon Kuvendit të komunës Draft-buxhetin komunal për miratim, në afatin e paraparë ligjor.

Neni 59
Buxheti i ndërmarrjeve publike lokale

1. Ndërmarrjet publike lokale, të cilat kryejnë shërbime publike lokale, i dorëzojnë Kuvendit të komunës buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më 1 dhjetor, para vitit të ardhshëm fiskal.
2. Në rast se një ndërmarrje ofron shërbime publike lokale për më shumë se një komunë, komuna bën marrëveshje me komunat gjegjëse, për lartësinë e tarifave dhe mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarive të asaj ndërmarrjeje.

Neni 60
Auditori i brendshëm

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Neni 61
Pasuria e komunës

1. Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Komuna ka të drejtë të shesë dhe të jepë me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.
3. Komuna mban dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim.
4. Kryetari/ja i/e komunës emëron komisione (ad hoc) me qëllim të regjistrimit të pasurisë së tundshme dhe të patundshme të komunës, më së voni një (1) muaj para përfundimit të vitit fiskal.
5. Të drejtën për të emëruar komisionin për regjistrimin e pasurisë e ka Kryetari i komunës.

KAPITULLI IX

Neni 62
Shërbimi civil komunal

1. Shërbimi civil i komunës udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës.
2. Shërbimi civil komunal, si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me nevoja të veçanta.
3. Të gjithë shërbyesit civilë komunal, i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë në pajtim me ligjin, i zbatojnë dhe i përfillin urdhrat e eprorëve të tyre, përveç rasteve kur detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin.

Neni 63
Udhëheqësi i personelit

1. Administrata e Komunës së Vushtrrisë ka udhëheqësin e personelit.
2. Procedurat për zgjedhjen, rekrutimin dhe largimin e tij i udhëheq Kryetari i komunës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik, brenda afatit ligjor.

KAPITULLI X

Neni 64
Konsultimet me publikun

1. Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):
 - 1.1. fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
 - 1.2. kontaktet me grupet e interesit, për t'i testuar dhe diskutuar politikat lokale;
 - 1.3. anketat për zbatimin e politikës lokale, duke përfshirë informimin e klientëve dhe qytetarëve që kanë interesa;
 - 1.4. shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje dhe prezentim;
 - 1.5. takimet publike;
 - 1.6. dëgjimet publike;
 - 1.7. studimet për vlerësim të efekteve të implementimit të vendimeve komunale, studime që duhet të bëhen nga komisionet profesionale, të caktuara nga Kuvendi komunal dhe për fushat e rëndësishme të qeverisjes komunale.

Neni 65
Organizimi i konsultimeve

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës, Kryetari/ja i/e komunës, komiteti dhe komisionet e Kuvendit të komunës, kanë autoritet të mbajnë konsultimet publike, për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.
2. Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun, duhet të publikohet katërmbëdhjetë (14) ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para së të merret vendimi.

Neni 66

Takimet me publikun

1. Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë adekuate për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Kryetari i komunës duhet të mbajë së paku dy takime me publikun në çdo vit kalendarik. Një në gjashtëmujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.
2. Përveç takimeve si në paragrafin paraprak të këtij neni, takimet tjera me publikun mund të mbahen për çështje tjera që janë me interes publik, atëherë kur Kryetari i komunës e sheh të arsyeshme.
3. Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik, duhet të shpallet së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrësit.
4. Përfaqësuesit e mediave duhet të ftohen që të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.
5. Në takimet publike janë të obliguar të marrin pjesë zyrtarët më të lartë të organeve të komunës si: Kryetari/ja i/e komunës, drejtorët e drejtorive dhe zyrtarët tjerë kompetentë.
6. Nëse bëhet një pyetje në takim publik, e që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, parashtruesi i pyetjes mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.
7. Për çdo takim publik mbahet procesverbali i cili duhet të ruhet me të gjitha informatat e hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga pjesëmarrësit e takimit publik dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme, duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.
8. Kërkesat dhe iniciativat e qytetarëve të evidentuara në procesverbalin e mbledhjes publike, Komiteti për Politike dhe Financa dhe Kuvendi i komunës, obligohen t'i shqyrtojnë brenda afatit prej 60 ditësh pas mbajtjes së mbledhjes dhe t'i njoftojë parashtruesit e kërkesave lidhur me vendimin e aprovuar.

Neni 67

Format tjera të konsultimit, pjesëmarrja publike dhe referendumi

1. Për çështjet e rëndësisë së veçantë, komuna organizon referendum.
2. Organizimi i referendumit bëhet në përputhje me ligjin përkatës.

Neni 68

Peticionet

1. Secili person fizik dhe juridik apo organizatë që ka interes në komunë, ka të drejtë t'i paraqitë
2. peticion Kuvendit të komunës, për cilëndo çështje që lidhet me punën e komunës. Peticioni është kërkesë për Kuvendin, për t'u marrë me çështjet specifike, apo për të miratuar rregullore dhe vendime të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.
3. Kuvendi i komunës duhet të njohë rëndësinë e peticionit dhe t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve

dhe kërkesave të përfshira në peticion. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik, në të cilin popullata diskuton për çështjet me interes për ta, bashkë me zyrtarët komunal.

4. Të gjitha peticionet mund t'i drejtohen Kuvendit të komunës, Kryetarit/es të komunës, Kryesuesit/es të Kuvendit, komiteteve të Kuvendit apo drejtorive komunale, drejtpërsëdrejti, nëpërmjet postës elektronike ose të shkruar.
5. Kuvendi i komunës nuk do të ketë parasysh asnjë peticion që ka të bëjë me çështje që nuk janë kompetencë dhe përgjegjësi e komunës dhe organeve të saj.
6. Secili peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit, emrat, numrin e letërnjoftimit dhe adresat e personave që e nënshkruan. Lënda e peticionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të peticionit/ankesës.
7. Kryesuesi/sja i/e Kuvendit në koordinim me Kryetarin/en i/e komunës, do të paraqitë çdo peticion para Kuvendit të komunës brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita që pranon peticionin, gjegjësisht në takimin e ardhshëm të radhës të Kuvendit të komunës, nëse në afatin e caktuar nuk është shqyrtuar i njëjti.

Neni 69 Përgjigje në peticion

1. Kuvendi i komunës do të marrë një vendim përfundimtar lidhur me lëndën e peticionit më së largu tridhjetë (30) ditë pasi të bëhet prezentimi i peticionit në Kuvendin e komunës.
2. Vendimi do të arsyetohet dhe do t'i komunikohet me shkrim organizatorit të peticionit.

Neni 70 Iniciativa qytetare

Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar projekt-rregullore brenda kompetencave të komunës, për miratim nga Kuvendi i komunës apo me votën e qytetarëve në pajtim me ligjin.

Neni 71 Organizatat jofitimprurëse

1. Komuna e Vushtrisë e përkrah aktivitetin e organizatave jofitimprurëse, aktiviteti i të cilave është ofrimi i shërbimeve në kuadër të përgjegjësive të përgjithshme të komunës.
2. Të gjitha këto organizata i përmbahen ligjit në fuqi kur ofrojnë shërbime dhe kur zhvillojnë aktivitete.

KAPITULLI XI

Neni 72

Informimi, komunikimi dhe qasja në dokumentet zyrtare

Organet komunale obligohen që t'i informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre, duke komunikuar drejtpërsëdrejti në gjuhën e tyre dhe duke ju lejuar qasje në dokumente zyrtare, në pajtim me ligjet përkatëse dhe aktet nënligjore.

Neni 73

Përdorimi i gjuhëve

Kuvendi i komunës miraton rregullore, që në mënyrë më të detajuar rregullon përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj, siç përcaktohet me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 74

Ankesat e qytetarëve

1. Çdo qytetar mund të parashtojë ankesë në afatin ligjor ndaj vendimit administrativ të organeve të komunës, nëse ai apo ajo mendon se i janë cenuar të drejtat e tij ose saj.
2. Shqyrtimi i ankesave do të bëhet në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me ligje të veçanta.

KAPITULLI XII

Dispozitat përfundimtare

Neni 75

Procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës

1. Iniciativa për hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës mund të ndërmerret nga:
 - 1.1. Kryetari i komunës;
 - 1.2. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të komunës, dhe
 - 1.3. 15% e qytetarëve të komunës me të drejtë vote.
2. Propozimi për ndryshimin e Statutit të komunës duhet t'i dërgohet Kuvendit të komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i komunës para shqyrtimit final, duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim, ndërkaq afati për konsultim me publikun nuk mund të jetë më i shkurtër se 14 ditë dhe as më i gjatë se 30 ditë.
3. Nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës miratohet me shumicën e

- anëtarëve të Kuvendit që janë prezent dhe votojnë.
4. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i komunës duhet të vendosë se a do të miratojë Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të marra.
 5. Kuvendi i komunës në rastin e marrjes së vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës dhe akteve tjera në kompetencë të Kuvendit të komunës, emëron një komision kompetent që do të përgatitë draftin e aktit për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, i cili do të jetë i balancuar në aspektin profesional, politik, etnik dhe gjinor.

Neni 76 **Konflikti i dispozitave**

Në rast kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat e ligjit do të mbizotërojnë.

Neni 77 **Dispozitat shfuqizuese**

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushojnë të vlejnë dispozitat e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.58/11, i datës 28.4.2011.

Neni 78 **Hyrja në fuqi**

Me aprovimin e këtij Statuti, të gjitha aktet tjera të komunës do të harmonizohen brenda gjashtë (6) muajve me Statutin në fuqi.

Neni 79 **Interpretimi i Statutit**

Interpretimin autentik të dispozitave të këtij Statuti e bën Kuvendi i komunës.

Neni 80 **Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit

